



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

ndërmjet

Autoritetit Kontraktues: Kryetarit të Komunës, Mehmet Ballazhi

DHE

Përfituesit: Shoqërisë Kulturore “Sharri” nga Hani i Elezit, Alban Laçi

Lënda e marrëveshjes

Neni 1

Lënda e kësaj marrëveshje është mbështetja financiare nga ana e Komunës për subvencionim të SHKA Sharri. Me këtë subvencionim do të mbulohen shpenzimet sipas projekt propozimit të paraqitur në Drejtorinë për Arsimim, Kulturë, Rini dhe Sport, me numër të protokollit 02.nr.3690/2022.

Obligimet e dyanshme

Neni 2

Palët e kësaj kontrate obligohen me kushtet e marrëveshjes. Derisa marrëveshja është nënshkruar, secila palë mund të tërhiqet nga marrëveshja pa pasoja financiare.

Vlera e Subvencionimit

Neni 3

1. Vlera e subvencionimit kap shumën prej 3,000.00 € tremijë euro dhe ndahet nga kategoria buxhetore subvencione dhe transfere.
2. Kjo është shuma e vetme dhe përfundimtare që paguhet nga Autoriteti Kontraktues për Përfituesin.

Obligimet e përfituesit

Neni 4

1. Mjetet e marra, përfituesi do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet e paraqitura në projekt.
2. Përfituesi duhet të raportoj tek Autoriteti Kontraktues mbrenda 30 ditëve pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.
3. Përfituesi duhet të sjellë tek Autoriteti Kontraktues:
 - raportin narrativ (shtojca e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje)
 - raportin financiar për mjetet e shpenzuara (shtojcën e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje)
 - kopje të faturave së bashku me kuponat fiskal
6. Çdo faturë duhet të jetë e rregullt me numër fiskal dhe e nënshkruar nga pala pranuese
7. Përfituesi duhet të dorëzoj të gjitha kopjet e faturave të paguara tek Autoritetit Kontraktues
8. Përfituesi paguan të gjitha taksat dhe tatimet siq parashihen me ligjet në fuqi
9. Njofton Autoritetin Kontraktues për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5

- ~~1. Autoriteti Kontraktues obligohet që shumën nga neni 3 i kësaj marrëveshje t'ia transferoj bartësit të subvencionuar sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje.~~
2. Shuma nga neni 3 bartet në xhirrollogarinë bankare të ofruar nga Përfituesi.
3. Autoriteti Kontraktues mban të drejtën e monitorimit/inspektimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit
4. Autoriteti Kontraktues mban të drejtën e auditimit të qëllimeve të subvencionimit.

Afatet kohore

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.
2. Kjo kontratë është e vlefshme 12 muaj pas datës së nënshkrimit nga palët.

Shkëputja e marrëveshjes

Neni 6

Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:

1. Tejkalimit të pa justifikueshëm të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje
2. Marrëveshjes me shkrim nga dyja palët në marrëveshje
3. Shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje dhe
4. Mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive

Kthimi i mjeteve

Neni 7

Në rastet e paraqitura në nenin 8 të kësaj marrëveshje, Përfituesi obligohet që shumën e marrë nga Autoriteti Kontraktues t'ia kthej të njëjtit, dhe atë menjëherë pasi të paraqiten kushtet që përbëjnë arsyeje të marrëveshjes.

Dispozitat tjera

Neni 8

~~Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të paraparë me projekt/kërkesë, Përfituesi është i obliguar t'i ktheje mjetet e pa shpenzuara tek Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditëve.~~

Neni 9

1. Kjo marrëveshje realizohet në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës
2. Çdo mosmarrëveshje ose kontest eventual lidhur me këtë marrëveshje, palët e kësaj marrëveshje do t'i zgjidhin vet, mirëpo nëse këtë nuk mund ta arrijnë, atëherë Gjykata kompetente do të zgjidh ç'do kontest eventual me kërkesë nga secila palë e kësaj marrëveshje.

Hyrja në fuqi

Neni 10

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

Neni 11

Marrëveshja është përpiluar në 3 kopje të njëjta për secilën palë.

Datë: 18.07.2022

Autoriteti Kontraktues:
Përfituesi:

Morren Roza

Mhuesh

(Emri dhe Mbiemri)

(Emri dhe Mbiemri)

Kryetari i Komunës

Mehmet Balla

M Balla

